



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01 Nr. 118-13057/2016

Dt. 11.03.2016

Duke u bazuar në nenin 90 paragrafi 2 pika 2.1, të Ligjit nr. 03/L-147 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 11 paragrafi 2 pika 2.1 e Rregullores nr.01/2012 për Ndërprerjen, Pezullimin dhe Përfundimine Marradhënies së Punës në Shërbimin Civil, Kryetarja e Komunës së Gjakovës, znj. Mimoza Kusari-Lila, me dt. 11.03.2016, nxjerr:

V E N D I M

- I. Nëpunësi civil Pashk Sylja, i sistemuar në vendin e punës Përgjegjës për statistika pranë Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, i cili ka qenë në pension të parakohshëm nga dt. 01.10.2014, i përfundon marradhënia e punës përfundimisht me dt. 14.03.2016, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit.

A r s y e t i m

Bazuar në evidencën e Njësisë së personelit dhe me shikimin e dokumentacionit personal të nëpunësit civil Pashk Sylja, i cili ka qenë në pension të parakohshëm nga dt. 01.10.2014, me saktësi vërtetohet se i njëjti me dt. 14.03.2016, e arrin moshën 65 vjeçare, e cila me dispozita ligjore në fuqi është mosha mandatorë e pensionimit dhe se bazuar në këto dispozita është krijuar baza juridike për përfundimin e marradhënies së punës nga data 14.03.2016.

Bazuar në këtë edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Këshilla Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë aktvendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh, prej ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i adresohet komisionit të ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

**Aktvendimi t'iu dorëzohet:** Nëpunësit Pashk Sylja, Drejtorisë për Buxhet dhe Financa -zyrtarit për paga z. Afim Radoniqi, Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural drejtorit z. Bekim Ermeni, Zyrës së personelit për evidencë - në Dosje dhe Arkivës.

Kryetarja e Komunës,

  
Znj. Mimoza Kusari - Lila